REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org.
Org.Jedinica 01
Org Unit
Nr.Prot:
Broj Prot
Prot.No 05-7425
Nr.i faqeve
Br.stranica -24-
No.pages
Data:
Datum:
Date: 25/09/2025
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit– Ured Ministra –Office of the Minister

Nr:146/XX/2025
Datë:23.09.2025

Zëvendësministri i Ministrisë i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 11 dhe 16 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nëparagrafi 6.1, si dhe Kërkesës me nr. prot. 05-7212 datë 17.09.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet Udhëzuesi për monitorim të zhvillimit të fëmijëve 0-6 vjeç në Kujdesin Parësor Shëndetësor.

II. Shtojcë e këtij vendimi është Udhëzuesi për monitorim të zhvillimit të fëmijëve 0-6 vjeç në Kujdesin Parësor Shëndetësor.

III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Zëvëndësministri i Shëndetsisë.

Dr. Arsim Berisha

Zëvendësminister i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *DPSSH;*
- *Departamentit ligjor*
- *Arkivit të MSh-së.*

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

UDHËZUES

PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT TË FËMIJËVE 0 - 6 VJEÇ NË KUJDESIN PARËSOR SHËNDETËSOR

Prishtinë, 2025

Përmbajtja

Shkurtesat 3

Përkufizimet 4

I. HYRJE 5

1.1 Audienca e cakut 8

1.2 Informimi dhe shpërndarja e udhëzuesit 8

II. ORGANIZIMI AKTUAL I KUJDESIT PËR FËMIJËT NË KPSH 9

2.1 Programi i vizitave në shtëpi për nënën dhe fëmijën 0-3 vjeç 9

III. INSTRUMENTET E STANDARDIZUARA PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT 10

3.1 Përshtatja dhe pilotimi i GMCD në Kosovë 11

IV. REKOMANDIMET E OBSH-SË PËR INTEGRIMIN E MONITORIMIT TË ZHVILLIMIT TË FËMIJËS 12

4.1 Përshtatja e rekomandimeve të OBSh-së për monitorimin e zhvillimit të fëmijës në kontekstin e Kosovës 12

4.2 Piketat zhvillimore sipas moshës bazuar në instrumentin GMCD 13

4.3 Piketat zhvillimore të moshës 4-6 vjeç bazuar në doracakun e OBSH 16

V. UDHËZIME MBI PËRDORIMIN E UDHËZUESIT PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT (GMCD) 18

VI. MONITORIMI I ZBATIMIT DHE RAPORTIMI 20

Aneks: Instrumenti GMCD për monitorim të zhvillimit 21

Shkurtesat

ECI	Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme (Early Childhood Intervention)
GMCD	Udhëzuesi për Monitorimin e Zhvillimit të Fëmijës (Guide for Monitoring Child Development)
KPSh	Kujdesi Parësor Shëndetësor
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MSh	Ministria e Shëndetësisë
NFH	Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
VSh	Vizitat në Shtëpi për nëna dhe fëmijë nga 0-3 vjeç

Përkufizimet

Monitorimi i zhvillimit: Monitorimi i zhvillimit ka për qëllim të përcjell dhe mbështes zhvillimin e çdo fëmije, duke iu referuar procesit të vlerësimit nëse një fëmijë është duke u zhvilluar sipas moshës së tij/saj.

Piketat zhvillimore: Piketat zhvillimore janë aftësi që shumica e fëmijëve i mbërrijnë në moshë të caktuar, si për shembull të kuptuarit, të dëgjuarit, ecja, të folurit, etj.

Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme (NFH): Ndërhyrja në fëmijërinë e hershme iu referohet shërbimeve për fëmijët e vegjël me rrezik për ngecje në zhvillim, me ngecje zhvillimore dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim të përmirësimit të zhvillimit të fëmijës, rritjes së kompetencave të familjes për mbështetjen e fëmijës, dhe promovimit të përfshirjes sociale të fëmijës dhe familjes.

Vështirësitë zhvillimore janë të gjitha ato kushte të cilat e vënë fëmijën në rrezik për zhvillim jo optimal, ose ndikojnë që një fëmijë të ketë çrregullim, ngecje apo aftësi te kufizuara. Gjithashtu, përfshinë fëmijët me kufizime në funksionimin e tyre dhe fëmijët që ballafaqohen me sfida për zhvillim deri në potencialin e tyre të plotë. [1]

Rritja e fëmijës: Rritja e fëmijës i referohet ndryshimeve fizike që ndodhin në trupin e një fëmije me kalimin e kohës, të tilla si lartësia, pesha, zhvillimi i organeve dhe maturimi fizik, përmasat e trupit si perimetri i kokës, kraharorit.

Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme: Zhvillimi në fëmijërinë e hershme i referohet procesit të zhvillimit kognitiv, fizik, gjuhësor, socio-emocional dhe motorik të fëmijëve, e cila fillon që nga konceptimi e deri në moshën 8 vjeçare.

Instrumentet e standardizuara për monitorimin e zhvillimit u referohen instrumenteve të standardizuara dhe të validuara për vlerësimin e zhvillimit të fëmijës në disa domene (fusha) zhvillimore në kontekst të familjes së fëmijës dhe komunitetit (bashkësisë). Instrumenti përcakton pikat e forta, faktorët mbrojtës dhe rreziqet e mundshme dhe na orienton në drejtim të ofrimit të mbështetjes dhe ndërhyrjeve që i nevojiten fëmijës.[2]

[1] Referenca : MONITORING CHILDREN'S DEVELOPMENT THROUGH PRIMARY HEALTH CARE IN EUROPE AND CENTRAL ASIA Directions for policy and practice, © United Nations Children's Fund (UNICEF) Regional Office for Europe and Central Asia and the World Health Organization Regional Office for Europe, 2024

[2] Referenca : MONITORING CHILDREN'S DEVELOPMENT THROUGH PRIMARY HEALTH CARE IN EUROPE AND CENTRAL ASIA Directions for policy and practice, © United Nations Children's Fund (UNICEF) Regional Office for Europe and Central Asia and the World Health Organization Regional Office for Europe, 2024

I. HYRJE

Studimet bashkëkohore kanë treguar se vitet e fëmijërisë së hershme janë themelore për një zhvillim të shëndetshëm të fëmijës. Përvojat e hershme formojnë mënyrën se si zhvillohet truri dhe ofrojnë bazën për të gjithë të mësuarit, sjelljen dhe shëndetin në të ardhmen[3]. Vitet e hershme janë veçanërisht të rëndësishme për fëmijët me ngecje zhvillimore apo aftësi të kufizuara. Mbështetja e duhur gjatë këtyre viteve kritike për fëmijët me vështirësi zhvillimore mund të përmirësojë zhvillimin e tyre, të përmirësojë pjesëmarrjen dhe përfshirjen, si dhe cilësinë e përgjithshme të jetës. Andaj, identifikimi i hershëm i vështirësive zhvillimore është i rëndësishëm në mënyrë që mbështetja të ofrohet në kohë, dhe ngecjet zhvillimore të shmangen apo adresohen.

Të drejtat e fëmijëve dhe specifikisht mbështetja e zhvillimit të fëmijës mbrohet përmes Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijës. Konventa thekson të drejtën për zhvillim në nenin 6, i cili thotë se çdo fëmijë ka të drejtën e natyrshme për jetën dhe se qeveritë duhet të sigurojnë mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës në masën maksimale të mundshme. Konventa thekson rëndësinë e sigurimit të burimeve dhe mbështetjes së nevojshme për fëmijët që të zhvillohen në aspektin fizik, mendor dhe social. Konventa thekson se zhvillimi i një fëmije ndikohet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë familjen, komunitetin dhe mjediset sociale. Konventa thekson detyrimin e shteteve për të marrë të gjitha masat e duhura për të promovuar dhe mbrojtur këto të drejta, duke siguruar kështu që fëmijët të mund të rriten në një mjedis qe mbështet zhvillimin e tyre tërësor.

Korniza e Kujdesit Gjithëpërfshirës (Nurturing Care Framework)[4], e zhvilluar nga OBSh, UNICEF, dhe Banka Botërore, ofron një udhërrëfyes për veprim se si të mbështetet zhvillimi i fëmijëve. Korniza bazohet në evidencën shkencore mbi atë se si rezultatet e zhvillimit të fëmijës ndikohen dhe si mund të përmirësohen nga politikat dhe ndërhyrjet. Kujdesi gjithëpërfshirës karakterizohet nga pesë shtylla kyçe për një zhvillim të shëndetshëm: shëndeti optimal, ushqyeshmëria, kujdesi i përgjegjshëm, mundësitë për edukimin e hershëm, si dhe mbrojtja dhe siguria.

Marrë parasysh rëndësinë e shërbimeve për fëmijët me ngecje zhvillimore apo aftësi të kufizuara, Ministria e Shëndetësisë (MSh), në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit, si dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (komponentë sociale), ka aprovuar Dokumentin Strategjik dhe Planin e Veprimit për shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme në Mars 2025.

Përmes këtij dokumenti strategjik, MSh synon krijimin e shërbimeve të NFH-së përmes ekipeve multidisiplinare të vendosura në Kujdesin Parësor Shëndetësor të cilat do të ofrojnë shërbime me familjen në qendër. Strategjia thekson identifikimin në kohë dhe qasjen në shërbime bashkëkohore për fëmijët me ngecje në zhvillim ose aftësi të kufizuara. Një komponentë e rëndësishme e dokumentit strategjik është identifikimi i hershëm i vështirësive zhvillimore, i cili do të mundësohet përmes monitorimit të zhvillimit të fëmijëve 0-6 vjeç në KPSH. Ky udhëzues derivon

---

[4] World Health Organization, United Nations Children's Fund, World Bank Group. *Nurturing carë for early childhood development: a framework for helping children survive and thrive to transform health and human potential.* Geneva: World Health Organization; 2018.

nga Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme – NFH 2025-2030.

Zhvillimi i hershëm i fëmijërisë shpesh kuptohet në faza të përcaktuara nga mosha. Përgjithësisht, dallohen tri faza të fëmijërisë së hershme:

***Nga konceptimi deri në lindje*:** Periudha prenatale kur shëndeti, ushqimi dhe mbrojtja për një grua shtatzënë është thelbësore. Shpesh, periudha nga konceptimi deri 24 muaj konsiderohen si 1000 ditët e para. Gjatë kësaj kohe, truri zhvillohet më shpejt dhe mund të ndikohet shumë nga ushqyerja, mbrojtja dhe kujdesi i përgjegjshëm.

Nga lindja deri në moshën 3 vjeç: Gjatë kësaj faze, truri vazhdon të evoluojë me shpejtësi. Në këtë aspekt ushqimi, mbrojtja dhe stimulimi që vjen nga loja, leximi, këndimi dhe ndërveprimet me të rriturit janë qenësore.

Vitet parashkollore: përfshin periudhën nga mosha 3 vjeç deri në moshën kur një fëmijë fillon shkollën. Kujdesi shëndetësor, ushqyerja dhe mbrojtja mbeten të rëndësishme gjatë kësaj faze, por duhet të plotësohen me mundësi të mësimit të hershëm në shtëpi dhe në mjedise parashkollore.

Rritja dhe zhvillimi i fëmijës janë dy koncepte të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe që kontribuojnë në mirëqenien e përgjithshme të fëmijës.

Rritja e fëmijës: i referohet ndryshimeve fizike që ndodhin në trupin e një fëmije me kalimin e kohës. Kryesisht fokusohet në ndryshimet sasiore në madhësinë dhe dimensionet fizike, të tilla si lartësia, pesha, zhvillimi i organeve dhe maturimi fizik, përmasat e trupit si perimetri i kokës dhe kraharorit. Rritja e fëmijës mund të matet lehtësisht duke përdorur tregues objektivë si lartësia, pesha dhe perimetri i kokës, të paraqitur zakonisht në grafikët e rritjes për të ndjekur progresin me kalimin e kohës.

Zhvillimi i fëmijës: i referohet ndryshimit që ndodh në sjelljet dhe aftësitë e fëmijës në fusha të ndryshme, duke përfshirë zhvillimin kognitiv, gjuhësor, social-emocional dhe motorik. Zhvillimi i fëmijës përfshin një gamë më të gjerë fushash, duke përfshirë zhvillimin kognitiv (të menduarit dhe gjykuarit), gjuhës (aftësitë e komunikimit), social-emocional (marrëdhëniet, emocionet) dhe zhvillimin motorik (lëvizja, koordinimi). Zhvillimi i fëmijës përfshin si ndryshimet sasiore më komplekse (p.sh., pasurimin e fjalorit) dhe ndryshimet cilësore (p.sh. përmirësimet në aftësitë e zgjidhjes së problemeve) në fusha të ndryshme të funksionimit.

Shkaqet e vështirësive zhvillimore në fëmijërinë e hershme mund të jenë të lidhura me shëndetin ose faktorët psikosocial. Të renditura nga më të zakonshmet tek ato më pak të zakonshmet, shkaqet janë[5]:

1. Kujdesi joadekuat dhe mungesa e mundësive për edukim të hershëm
2. Kequshqyerja
3. Mungesa e mikronutrientëve, si mungesa e hekurit dhe jodit

[5] UNICEF Regional Office for Europe and Central Asia and WHO Regional Office for Europe, *Monitoring Children's Development in Europe and Central Asia with w Focus on Primary Health Care: Directions for Policy and Practice.* Geneva, 2024.

4. Problemet perinatale, si prematuriteti, asfiksia dhe ngecja e rritjes intrauterine
5. Sëmundjet kronike, sëmundjet kongjenitale të zemrës, fibroza cistike
6. Aksidentet dhe traumat
7. Infeksionet që çojnë në dëmtime ose kequshqyerje
8. Çrregullime të zhvillimit kongjenitale/gjenetike/metabolike/të lindura, të tilla si çrregullimi i spektrit të autizmit, sindroma Down ose hipotiroidizmi
9. Dëmtime të dëgjimit ose shikimit
10. Ekspozimi ndaj substancave toksike qoftë gjatë shtatzënisë (p.sh., alkooli) ose pas lindjes (p.sh. plumbi).

Hulumtimet bashkëkohore tregojnë se duke ofruar shërbime të ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme, të cilat kanë familjen në qendër, dhe të cilat ofrohen përmes një qasje ndërdisiplinore dhe përmes bashkëpunimit ndër sektorial, fëmijët me ngecje në zhvillim dhe/ose aftësi të kufizuara ndihmohen që të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Për ofrimin e shërbimeve të NFH është e rëndësishme që identifikimi i ngecjeve zhvillimore dhe aftësive të kufizuara të bëhet në fazat sa më të hershme.

Monitorimi i zhvillimit ka për qëllim përcjelljen dhe mbështetjen e zhvillimit të çdo fëmije[6], ofron mundësi për të identifikuar vështirësitë në zhvillim në fazë të hershme dhe për të adresuar këto vështirësi përmes ndërlidhjes me shërbimet e NFH. Gjatë monitorimit të zhvillimit, profesionistët shëndetësor informojnë familjet mbi rëndësinë e zhvillimit të hershëm të trurit, pyesin për ndonjë shqetësim që mund të kenë në lidhje me zhvillimin e fëmijës së tyre, së bashku potencojnë pikat e forta dhe mësojnë për kujdesin gjithëpërfshirës dhe për atë që familja mund të bëjë për të ofruar mbështetje. Interpretojnë funksionimin e fëmijës duke vlerësuar gjuhën shprehëse, gjuhën pranuese (komunikimin), lëvizjet e mëdha dhe lëvizjet fine (të imëta), raportet me prindërit dhe të tjerët, lojën dhe vetë kujdesin.

Institucionet shëndetësore, e në veçanti institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSh) të cilat janë pika e parë e kontaktit me fëmijët dhe familjet, janë faktor kyç për monitorimin e zhvillimit të fëmijës dhe identifikimin e hershëm. Monitorimi mund të integrohet si komponentë në vizitat rutinë të fëmijës si tek mjeku familjar, ashtu edhe në vizitat në shtëpi të cilat ofrohen në kuadër të programit të Vizitave në Shtëpi për nëna dhe fëmijë.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe UNICEF, në dokumentin "Monitorimi i Zhvillimit të Fëmijëve përmes Kujdesit Parësor Shëndetësor në Evropë dhe Azinë Qendrore: Udhëzime për Politikën dhe Praktikën" rekomandon tri veprime për integrimin e monitorimit të zhvillimit në sistemet shëndetësore:

1. Sistemet shëndetësore duhet të gjejnë mundësitë për të integruar monitorimin e zhvillimit në kuadër të shërbimeve ekzistuese. Kushtet optimale për kryerjen e monitorimit të zhvillimit mund të jenë kur fëmijët sillen për vaksinim ose vizita rutinë të fëmijëve.

[6] MONITORING CHILDREN'S DEVELOPMENT THROUGH PRIMARY HEALTH CARE IN EUROPE AND CENTRAL ASIA Directions for policy and practice, © United Nations Children's Fund (UNICEF) Regional Office for Europe and Central Asia and the World Health Organization Regional Office for Europe, 2024

2. Sistemet shëndetësore duhet të përfshijnë zhvillimin e fëmijëve në përmbajtjen e çdo vizite shëndetësore rutinë dhe të iu sigurojnë profesionistëve shëndetësorë burime të mjaftueshme për të adresuar zhvillimin e fëmijës gjatë këtyre vizitave.
3. Sistemet shëndetësore duhet të synojnë të ofrojnë monitorim të zhvillimit në mënyrë universale për të gjithë fëmijët e moshës parashkollore (0-6 vjeç).

1.1 Audienca e cakut

Monitorimin e zhvillimit të fëmijëve sipas këtij udhëzuesi mund ta bëjë vetëm mjeku specialist udhëheqës i ekipes së NFH si dhe profesionistët dhe bashkëpunëtore shëndetësor të trajnuar në zbatimin e këtij udhëzuesi, ekskluzivisht nen mbikëqyrjen e mjekut kompetent/udhëheqës i ekipes se NFH. Udhëzuesi do të përdorët në KPSh, gjegjësisht në qendrat e mjekësisë familjare dhe vizitat në shtëpi.

1.2 Informimi dhe shpërndarja e udhëzuesit

Pas miratimit final, udhëzuesi do të shpërndahet dhe prezantohet tek të gjithë profesionistët shëndetësorë në KPSh, të cilët do ta zbatojnë atë në praktikë. Shpërndarja e këtij udhëzuesi për zbatim nga institucionet e KPSh-se bëhet përmes Qarkores Informative të nxjerrë nga MSh.

Për informimin e profesionistëve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë të KPSh-së dhe në shpërndarjen e udhëzuesit do të zbatohen këto metoda:

- Publikimi në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të MSh;
- Organizimi i trajnimeve mbi monitorimin e zhvillimit nga MSH në bashkëpunim me partnerët/donatorët;
- Promovimi në mediat elektronike dhe të shkruara.

II. ORGANIZIMI AKTUAL I KUJDESIT PËR FËMIJËT NË KPSH

Udhëzimi Administrativ (UA) për KPSh përcakton standardet e ofrimit të shërbimeve, përfshirë shërbimet për nënën dhe fëmijën. KPSh organizohet përmes rrjetit të institucioneve në QKMF dhe njësitë përbërëse të saj, siç janë Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca e Mjekësisë Familjare (AMF). Ekipi i mjekësisë familjare përbëhet nga mjeku familjar dhe dy infermierë, të cilët ofrojnë kujdes individual, familjar dhe në bashkësi.

Shtojca 2 e UA për KPSh definon shërbimet e kujdesit për fëmijë, ku hyjnë kujdesi parandalues dhe edukimi i familjes, monitorimi i zhvillimit dhe rritjes së fëmijës, kontrollet e fëmijës sipas moshës, monitorimi i ushqyeshmërisë dhe matjet antropometrike. Këto shërbime ofrohen në institucionet e KPSh dhe në komunitet në kuadër të Programit të Vizitave në Shtëpi për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç.

2.1 Programi i vizitave në shtëpi për nënën dhe fëmijën 0-3 vjeç

Programi i Vizitave në Shtëpi në Kosovë ka filluar zbatimin në vitin 2014. Aktualisht ky program është i integruar në sistemin e KPSh dhe zbatohet në 30 komuna të vendit. Programi i vizitave në shtëpi ka për qëllim përmirësimin e qasjes në shërbimet e KPSH për gratë shtatzëna, fëmijët nën moshën tre vjeç dhe prindërit e tyre. Objektivat specifike të programit të vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë janë:

1. Vlerësimi i shëndetit dhe mirëqenies së nënave dhe fëmijëve të tyre duke përfshirë statusin e zhvillimit të fëmijës.
2. Vlerësimi i nevojave shëndetësore dhe ushqyese të familjes dhe
3. Edukimi i familjeve, si dhe referimi dhe koordinimi me skemat e ndryshme të mbështetjes së komunitetit.

Vizitat në shtëpi realizohen sipas standardeve të aprovuara nga MSh.

Programi i Vizitave në Shtëpi do të ketë rol të rëndësishëm për lehtësimin e qasjes së fëmijëve në shërbimet e NFH-së, veçanërisht përmes identifikimit të hershëm të vështirësive zhvillimore, i cili mund të bëhet përmes monitorimit të zhvillimit nga profesionistët të cilët ofrojnë shërbime në kuadër të këtij programi.

III. INSTRUMENTET E STANDARDIZUARA PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT

Monitorimi i zhvillimit ka për qëllim të përcjellë dhe të mbështesë zhvillimin e secilit fëmijë në bashkëpunim me familjen, dhe të mbështes ofrimin e kujdesit gjithëpërfshirës të fëmijës. Monitorimi përfshin faktorët e rrezikut që mund të jenë të pranishëm në jetën e familjes dhe se si familja po përballet me këto rreziqe. Piketat zhvillimore përdoren më së shpeshti për të monitoruar progresin në zhvillimin e fëmijëve, të cilat tregojnë aftësitë zhvillimore që pritet të fitojnë fëmijët mesatarisht në një moshë të caktuar. Arritja e piketave kryesore në fëmijërinë e hershme zakonisht ndjek një trajektore normale, ku shumica e fëmijëve i arrijnë piketat zhvillimore, ndërsa një përqindje e vogël nuk i arrijnë apo i tejkalojnë ato.

Instrumentet për monitorimin e zhvillimit të fëmijës janë mjete të standardizuara, të validuara dhe përshtatura në aspektin kulturor, të bazuara në teori shkencore, të cilat profesionistëve shëndetësorë u ndihmojnë që të kuptojnë se si fëmija po zhvillohet në të gjitha fushat e zhvillimit. Kur përdoren në mosha dhe faza të ndryshme të zhvillimit, ato janë të dizajnuara për të identifikuar vështirësi të ndryshme, duke përfshirë vështirësi fizike, motorike, vizuale, dëgjimore dhe të të nxënit ose vonesa, si dhe zhvillimin kognitiv, social, emocional dhe kujdesin për veten.

Instrumentet e standardizuara me përdorimin më të madh janë:

- Ages and Stages Questionnaire (ASQ)
- Guide for Monitoring Child Development (GMCD)
- Denver Developmental Screening Test
- Bayley Scales of Infant and Toddler Development

Instrumenti i përshtatur dhe përdorur në Kosovë është Udhëzuesi për Monitorimin e Zhvillimit të Fëmijës (Guide for Monitoring Child Development - GMCD). GMCD është pako gjithëpërfshirëse, e cila u mundëson profesionistëve shëndetësorë të monitorojnë dhe mbështesin zhvillimin e fëmijëve, si dhe të identifikojnë dhe adresojnë vështirësitë zhvillimore. GMCD është standardizuar dhe validuar ndërkombëtarisht dhe mund të aplikohet për çdo fëmijë të moshës 0-42 muajsh, pa pasur nevojë për ri-standardizim apo ri-validim.

Përmes GMCD-së bëhet monitorimi dhe mbështetja e zhvillimit në shtatë fusha zhvillimore:

1) Gjuha shprehëse (të folurit);
2) Gjuha pranuese (të kuptuarit);
3) Lëvizjet fine (të imëta);
4) Lëvizjet e mëdha;
5) Kontakti (krijimi i lidhjes);
6) Loja;
7) Vetë kujdesi.

Instrumenti GMCD është validuar përmes një studimi me një mostër të gjerë prej 12,000 fëmijëve nga 4 vende të ndryshme të botës. Ky studim ka treguar se fëmijët e shëndetshëm arrijnë piketat zhvillimore të GMCD-së në mosha të ngjashme, gjë e cila e bën GMCD të përshtatshme për përdorim edhe në vende të tjera, pa pasur nevojë për validim shtesë.

Krahas komponentës së monitorimit, GMCD përmban edhe komponentën e 'mbështetjes' së fëmijës përmes Librit Mbështetës. Përmes qasjes së individualizuar dhe duke u mbështetur në informacionet nga monitorimi i zhvillimit, komponenta mbështetëse u mundëson profesionistëve shëndetësorë të ofrojnë këshilla dhe rekomandime për mbështetjen e fëmijës. Në këtë mënyrë, përmbyllet cikli i cili fillon nga monitorimi i zhvillimit, identifikimi dhe mbështetja e fëmijës.

3.1 Përshtatja dhe pilotimi i GMCD në Kosovë

Instrumenti për Monitorimin e Zhvillimit të Fëmijës është pilotuar në dy komuna, Viti dhe Suharekë. Sipas vendimit të grupit punues të Vizitave në Shtëpi, është rekomanduar që fillimisht të pilotohet në kuadër të programit të Vizitave në Shtëpi, duke qenë se natyra e programit mundëson integrim më të lehtë të instrumentit duke marrë parasysh kohën e vizitës dhe objektivat e vizitës të cilat përputhen me rolin e GMCD (monitorimi i zhvillimit).

Trajnimet e para për zbatimin e GMCD janë realizuar gjatë muajve Mars -Maj 2024. Zbatimi i GMCD është pilotuar në dy komuna Suhareke dhe Viti. Gjatë muajve Prill dhe Maj 2024 janë realizuar vizita monitoruese nga ekipi i trajnerëve të GMCD-së në dy komunat pilotuese. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i integrimit te instrumentit gjatë vizitave, si dhe evidentimi i sfidave. Sipas raportit, nga të gjithë fëmijët e vlerësuar 14% janë identifikuar me nevojë për mbështetje shtesë në një ose më shumë fusha zhvillimore të GMCD-së.

IV. REKOMANDIMET E OBSH-SË PËR INTEGRIMIN E MONITORIMIT TË ZHVILLIMIT TË FËMIJËS

Udhëzuesi i publikuar nga OBSh i quajtur ''Doracaku i Kujdesit Parësor Shëndetësor për Fëmijë dhe Adoleshentë''(Pocket Book of Primary Health Care for Children and Adolescent)[7], i cili definon standardet e kujdesit shëndetësor të bazuara në evidencë, rekomandon që monitorimi i zhvillimit të fëmijës të jetë pjesë e integruar e vizitave të rregullta në KPSh për fëmijët. Doracaku ofron udhëzime të shkurtra për ofruesit e KPSh, duke sugjeruar që ata të "monitorojnë zhvillimin, të mbështesin zhvillimin e fëmijës dhe të përcaktojnë nëse ka fusha që kërkojnë mbështetje shtesë, të identifikojnë dhe adresojnë faktorët e rrezikut për vështirësitë zhvillimore dhe të trajtojnë këto vështirësi kur ato shfaqen".

Përgjatë periudhës 0-6 vjeç, OBSh rekomandon gjithsej 10 vizita rutinë për fëmijët e shëndetshëm në KPSh, prej të cilave në 8 prej tyre rekomandon monitorimin e zhvillimit, krahas monitorimit të rritjes.

4.1 Përshtatja e rekomandimeve të OBSh-së për monitorimin e zhvillimit të fëmijës në kontekstin e Kosovës

Marrë për bazë rekomandimet e OBSh-së për vizitat rutinë dhe monitorimin e zhvillimit, në tabelën më poshtë është prezantuar integrimi i monitorimit të zhvillimit në shërbimet e KPSh-së sipas kontekstit të Kosovës.

Koha e vizitës	Lloji i vizitës	Mënyra e vlerësimit të zhvillimit
Një muajsh	Vizitë rutinë te mjeku familjar	Instrumenti GMCD
Tre muajsh	Vizitë rutinë te mjeku familjar	Instrumenti GMCD
Gjashtë muaj	Vizitë në shtëpi nga infermieret	Instrumenti GMCD
Një vjeç	Vizitë në shtëpi nga infermieret	Instrumenti GMCD
Dy vjeç	Vizitë rutinë te mjeku familjar	Instrumenti GMCD
Tri vjeç	Vizitë në shtëpi nga infermieret	Instrumenti GMCD
Katër vjeç	Vizitë rutinë te mjeku familjar	Piketat zhvillimore
Pesë-gjashtë vjeç	Vizitë rutinë te mjeku familjar	Piketat zhvillimore
Gjashte vjec	Vizitë rutinë te mjeku familjar	Piketat zhvillimore

*Për moshat katër, pesë gjashtë vjeç, monitorimi bëhet sipas piketave zhvillimore të OBSH.

Monitorimi sistematik i zhvillimit të fëmijëve do të bëhet në te gjitha institucionet e KPSh nga mjeku familjar, mjeku i përgjithshëm gjatë vizitave rutinë, apo nga infermieret në institucionin shëndetësor, gjatë vizitave në shtëpi si dhe kurdo që fëmija është i qasshëm sipas standardeve të vizitave të këtij programi. Institucionet e KPSh do të pajisjen me formularët e monitorimit të zhvillimit (GMCD), të cilët do të plotësohen gjatë vizitës dhe do të mbahen në institucion.

[7] World Health Organization, *Pocket book of primary health care for children and adolescents*, 2022, https://iris.who.int/handle/10665/352485

4.2 Piketat zhvillimore sipas moshës bazuar në instrumentin GMCD

➢ Një muaj

Instruksionet: Të zbatohet instrumenti GMCD dhe të vlerësohet arritja e piketave si më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësorë të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës.

Gjuha shprehëse	Gjuha pranuese	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja
▪ Relaksohet kur mbahet ▪ Bën zëra të ndryshëm kur është i/e gëzuar, irrituar, uritur	▪ Reagon kur flet me të, ngadalëson lëvizjet, dëgjon, merr pjesë ▪ Tregon interesimin duke shikuar fytyrën kur flet prindi	▪ Ngre fytyrën kur shtrihet në bark ▪ Kthen kokën ▪ Lëviz krahët dhe këmbët në mënyrë të barabartë nga të dyja anët	▪ Mban duart hapur (jo grushtuar) disa herë	▪ Shikon, përcjellë fytyrat ▪ Buzëqesh kur i flet këndshëm prindi	▪ Bashkëpunon kur luan me prindërit (lëviz gjymtyrët)

➢ Tre muaj

Instruksionet: Të zbatohet instrumenti GMCD dhe të vlerësohet arritja e piketave më si më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësore të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës.

Gjuha shprehese	Gjuha pranuese	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja
▪ Shqipton zanoret ("aa, uu")	▪ Përgjigjet duke lëshuar tinguj kur i flasin prindërit	▪ Ngrit dhe mban kokën në mënyrë të qëndrueshme	▪ Bashkon duart në mes	▪ Mban kontakt të zgjatur dhe kuptimplotë me sy	▪ Bën tinguj në përgjigje të luajtjes

➢ **6 muaj**

Instruksionet: Të zbatohet instrumenti GMCD dhe të vlerësohet arritja e piketave më si më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësore të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës.

Gjuha shprehëse	Gjuha pranuese	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja
▪ Qesh me zë	▪ Përgjigjet duke lëshuar tinguj kur i flasin prindërit	▪ Ngre kokën 90° ▪ Ulet me ndihmë ▪ Kur mbahet në këmbë, drejton këmbët, shtyn kundër diçka je në vend që të përkulë këmbët	▪ Mban duart hapur (jo grushtuar) shumicën e kohës ▪ Zgjatet drejt objekteve me duar ▪ Kap, mban lodrat/ gjësendet (jo refleks i mbajtjes)	▪ Tregon dëshirën për t'u angazhuar me njerëzit duke parë, buzëqeshur, duke arritur, duke lëshuar tinguj ▪ Tregon preferencën dhe njohjen e prindërve duke prekur, buzëqeshur, apo inspektuar fytyrat e tyre	▪ Kap lodrat/gjësendet me interes (jo refleks) ▪ I sjell lodrat/ gjësendet në gojë ▪ Shikon duart e veta

➢ **12 muaj**

Instruksionet: Të zbatohet instrumenti GMCD dhe të vlerësohet arritja e piketave më si më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësore të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës.

Gjuha shprehëse	Gjuha pranuese	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja	Vetëkujdesi
▪ Thotë një fjalë kuptimplotë ▪ Përdor krahun ose dorën për të treguar njerëzit ose objektet	▪ Kupton foljet/veprimet (eja, merr, ndalo) ▪ Kupton emrat e objekteve (top, lodër)	▪ Mundohet të qëndrojë duke u mbajtur në objekte ▪ Arrin të qëndrojë në këmbë për një çast pa u mbajtur ▪ Ecën duke u mbajtur pas objekteve	▪ Kap objekte të vogla duke përdorur vetëm gishtat (gishti i madh dhe gishti tregues)	▪ Në mënyrë spontane kërkon të ndajë kënaqësinë dhe interesin me të tjerët (përqafon prindin, puth, inspekton lodrën së bashku)	▪ Fillon lojën "peek-a-boo" ▪ Inspekton se si funksionojnë lodrat/objektet (si rrotullohen rrotat, lëviz kukulla, ndizen dritat)	▪ Përdor gishtat për të ushqyer veten (e di se është ushqim dhe ha)

➢ **24 muaj**

Instruksionet: Të zbatohet instrumenti GMCD dhe të vlerësohet arritja e piketave më si më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësore të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës.

Gjuha shprehëse	Gjuha pranuese	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja	vetë kujdesi
▪ Përdor 6 fjalë kuptimplota ▪ Përdor kombinim fjalësh dhe gjestesh për të komunikuar dëshirat ▪ Të huajt kuptojnë një pjesë të komunikimit të fëmijës	▪ Kupton më shumë se një urdhër të thjeshtë	▪ Godit topin me këmbë ose ndonjë objekt tjetër	▪ Mban laps ose shkop (në çfarëdo mënyre) dhe shkarravit në letër ose në tokë/dyshe me	▪ Inicion ndërvepri me me njerëzit	▪ Përfshin të tjerët në lojë	▪ Përdor njërin nga mjetet ushqyese ▪ Pi nga gota

➢ **36 muaj**

Instruksionet: Të zbatohet instrumenti GMCD dhe të vlerësohet arritja e piketave më si më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësore të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës.

Gjuha shprehëse	Gjuha pranuese	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja	Vete kujdesi
▪ Përdor fjali me 4 fjalë për të komunikuar ▪ Përdor kohën e kaluar ▪ Tregon një histori ose një ngjarje ▪ Prindërit e kuptojnë gjithë komunikimin e fëmijës	▪ Kupton udhëzimet dypalëshe ("shko në kuzhinë dhe më sill pjatën tënde", "shko në dhomën tënde dhe sill topin")	▪ Godit topin me këmbë ose ndonjë objekt tjetër	▪ Mban me gishta lapsin ose shkopin dhe vizaton	▪ Flet për njerëzit/miqtë e preferuar kur nuk janë me të ("ku është gjyshi?")	▪ Krijon lojëra më komplekse që përfshin dy ose më shumë ide të tilla si gatimi dhe ushqyerja e një kukulle; drejtimi dhe mbushja e makinës, vetëm ose me të tjerët	▪ Përdor tualetin gjatë ditës ▪ Pastron dhëmbët me ndihmë

4.3 Piketat zhvillimore të moshës 4-6 vjeç bazuar në doracakun e OBSH

4 vjet

Instruksionet: Të vlerësohet zhvillimi i fëmijës karshi piketave zhvillimore në tabelën më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësore të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës, si dhe këshillohet ndjekja e programit të edukimit të hershëm.

Gjuha	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja	Vetëkujdesi
▪ Përdor fjali me të paktën gjashtë fjalë të përshtatshme për moshën ▪ Tregon histori në një rrjedhë logjike ▪ Pyet "pse", "si", "ku".	▪ Kërcen mbi një hapësirë 20-50 cm të gjerë	▪ Mban stilolapsin siç duhet me tre gishta ▪ Vizaton rrathë të mbyllur	▪ Toleron zhgënjimet e lehta	▪ Luan me fëmijët e tjerë të së njëjtës moshë (loja me role, ndjek rregullat)	▪ Zhvishet pa ndihmë

5 vjet

Instruksionet: Të vlerësohet zhvillimi i fëmijës karshi piketave zhvillimore në tabelën më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësore të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës, si dhe këshillohet ndjekja e programit të edukimit parashkollor.

Gjuha	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja
▪ Tregon histori në një logjikë të saktë dhe renditja kronologjike në fjalitë e thjeshta të sakta ▪ Shqiptim pothuajse i përsosur	▪ Ecën lart dhe poshtë me fytyrë përpara dhe duke përdorur hapa të rritur, pa u mbajtur ▪ Kërcen dhe qëndron shkurt në njërën këmbë ▪ Kap topa të mëdhenj	▪ Mban lapsin si një i rritur, vizaton drejtkëndëshin dhe trekëndëshin kur i tregohet se si	▪ Toleron zhgënjimet e lehta	▪ Luan me fëmijët e tjerë, të gatshëm për të ndarë (lojë me role, luaj sikur jam kafshë)

6 vjet

Instruksionet: Të vlerësohet zhvillimi i fëmijës karshi piketave zhvillimore në tabelën më poshtë. Po ashtu, të identifikohen rreziqet psikosociale dhe shëndetësore të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimin e fëmijës.

Gjuha	Motorika e gjerë	Motorika fine	Kontakti	Loja
▪ Tregon histori në një logjikë të saktë dhe renditja kronologjike në fjalitë e thjeshta të sakta ▪ Shqiptim pothuajse i përsosur	▪ Ecën lart dhe poshtë me fytyrë përpara dhe duke përdorur hapa të rritur, pa u mbajtur ▪ Kërcen dhe qëndron shkurt në njërën këmbë ▪ Kap topa të mëdhenj	▪ Mban lapsin si një i rritur, vizaton drejtkëndëshin dhe trekëndëshin kur i tregohet se si	▪ Toleron zhgënjimet e lehta	▪ Luan me fëmijët e tjerë, të gatshëm për të ndarë (lojë me role, luaj sikur jam kafshë)

V. UDHËZIME MBI PËRDORIMIN E UDHËZUESIT PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT (GMCD)

Hapi 1: Futja e të dhënave bazike

Fillimisht futni të dhënat bazike të institucionit dhe fëmijës, siç janë emri i institucionit dhe profesionistit shëndetësor, emri i fëmijës dhe prindit/kujdestarit, kontakti dhe informacione të tjera relevante. Tutje, duhet të vendoset data e vizitës, data e lindjes së fëmijës, pesha në lindje, si dhe problemet perinatale dhe diagnoza nëse janë të pranishme.

Emri i institucionit:	**Vizita 1**	**Dita**	**Muaji**	**Viti**	**Pesha në lindje:**	**Mosha gestative (MG) javë:**
Emri i ofruesit të shërbimit:	Data e vizites				Problemet perinatale nëse janë të pranishme:	
Emri i fëmijës:	Data e lindjes					
Emri i prindit/kujdestarit:	Mosha e kalkuluar				Diagnoza mjekësore nëse është e pranishme:	
Kontakti i familjes:	Nëse MG < 37 (40 MG)					
Informacione të tjera:	Mosha e korrigjuar					

Hapi 2: Njoftimi i prindit me procesin dhe qëllimin e monitorimit të zhvillimit

Thuaji si në vijim: "Ashtu siç është e rëndësishme të ndiqni shëndetin dhe rritjen fizike (të fëmijës suaj), është e rëndësishme të ndiqni dhe mbështesni zhvillimin e saj/tij. Truri i fëmijëve zhvillohet më shpejt gjatë viteve të hershme. Është e rëndësishme të monitorohet zhvillimi dhe të shihet nëse ka fusha që kanë nevojë për mbështetje shtesë. Ju e njihni më së miri fëmijën tuaj. Le të flasim 5-10 minuta për zhvillimin e tij/saj. Me zhvillim nënkuptoj të mësuarit, komunikimin, të kuptuarit, lidhjen me njerëzit, lojën, lëvizjen e trupit, përdorimin e duarve dhe gishtërinjve, dëgjimin dhe shikimin".

Hapi 3: Parashtroni 10 pyetjet standarde sipas Udhëzuesit

Pyetja 1. **Shqetësimet e prindit**. Do të doja t'ju pyesja së pari, a keni ndonjë shqetësim për zhvillimin e fëmijës tuaj në ndonjë nga këto fusha?"

Pyetja 2. **Gjuha shprehëse.** "Si ju bën të ditur fëmija juaj kur dëshiron diçka? Çfarë lloj tingujsh, gjestesh apo fjalësh përdor fëmija?"

Pyetja 3. **Gjuha pranuese.** "Si ju tregon fëmija që kupton kur i flisni? Për shembull, çfarë bën ai/ajo kur i thua: Ku është babi? Ku është topi? Eja këtu!"

Pyetja 4a. **Lëvizjet e motorikes së gjerë (muskujt e mëdha).** "Më trego për lëvizjen e tij/saj, si mbajtja dhe ngritja e kokës, pozita ulur, duke ecur."

Pyetja 4b. **Lëvizjet e motorikes fine (muskujt e vegjël).** "Si i përdor duart dhe gishtat e tij/saj, si për shembull mbajtja e gjësendeve?"

Pyetja 5. **Kontakti.** "Si lidhet (krijon kontakt) fëmija juaj me njerëzit që njeh? Si tregon interes për ta?" Çfarë bën për t'i angazhuar ata? Si është kontakti i fëmijës me sy?"

Pyetja 6. **Loja.** "Më tregoni për lojën e fëmijës suaj. "Si luan ai/ajo me njerëz, me sende apo lodra?"

Pyetja 7. **Vet kujdesi** ***(Për fëmijët mbi 12 muajsh).*** "Çfarë bën fëmija për veten? Si p.sh., a ushqehet vetë?"

Pyetja 8. **Mjedisi i kujdesit gjithëpërfshirës.** "Tani ju lutem më tregoni për jetën tuaj të përditshme. Çfarë bëni ju dhe familja juaj në shtëpi për ta ndihmuar fëmijën të zhvillohet, të mësojë, të komunikojë?"

Pyetja 9. **Rreziqet zhvillimore.** "Ndonjëherë prindërit/kujdestarët mund të përballem me shumë gjëra. Për shembull, ata mund të ndihen të mbingarkuar, të stresuar ose të dëshpëruar, mund të ketë probleme financiare ose sëmundje në familje dhe prindërit/kujdestarët mund ta kenë të vështirë të mbështesin zhvillimin e fëmijës së tyre. A keni vështirësi të tilla apo të tjera në situatën tuaj familjare?"

Pyetja 10. **Planifikimi për ndërhyrje dhe përcjellje.** "Cilat janë disa ide apo plane që keni për të mbështetur zhvillimin [e fëmijës suaj] pavarësisht këtyre vështirësive? Në këtë moshë të hershme kur zhvillimi është kaq i rëndësishëm, çfarë mund të bëni ju, familja juaj, miqtë dhe komuniteti për ta ndihmuar atë të zhvillohet?"

Hapi 4: Kodimi dhe interpretimi i rezultateve

Bazuar në përgjigjet e prindit, kodoni rezultatet me **PO** në piketat zhvillimore të cilat janë arritur dhe **JO** ato të cilat fëmija nuk mund t'i bëjë ende.

Interpretimi i rezultateve:

- Nëse piketat zhvillimore poshtë moshës së fëmijës janë të gjitha PO, atëherë zhvillimi i fëmijës është i përshtatshëm më moshën. Në këtë rast, në kolonën e fundit në të djathtë shëno: '*OK*'.
- Nëse ndonjëra prej piketave zhvillimore poshtë moshës së fëmijës është JO, atëherë fëmija mund të ketë ngecje në zhvillim dhe ka nevojë për mbështetje shtesë. Në këtë rast, në kolonën e fundit në të djathtë shëno: '*Mbështetje shtesë*'.

Hapi 5: Ndani rezultatet me prindërit/kujdestarin dhe planifikoni hapat e mëtutjeshëm.

Rezultatet e fituara nga vlerësimi ndani me prindërit. Theksoni pikat e forta dhe fushat në të cilat fëmija ka nevojë për mbështetje shtesë. Planifikoni së bashku me prindin vizitën e radhës apo diskutoni referimin tutje nëse kjo është e nevojshme. Në rastet kur evidentohen rreziqe psiko-sociale, është e rëndësishme që të koordinohet mbështetja përmes bashkëpunimit ndër sektorial. Këtu mund të përfshihen referimet në Qendrat për Punë Sociale për rastet kur evidentohet neglizhence apo abuzim ndaj fëmijës dhe brenda familjes, apo në institucionet e edukimit të hershëm për fëmijët të cilët nuk ndjekin edukimin parashkollor.

VI. MONITORIMI I ZBATIMIT DHE RAPORTIMI

Monitorimi i zhvillimit të hershëm do të bëhet në shërbimet rutinë të fëmijëve 0-6 në KPSh, përfshirë edhe programin e vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç, i cili ofron një mundësi të vlefshme për identifikimin e hershëm, pasi që fëmijët vizitohen të paktën pesë herë nga lindja deri në moshën tre vjeçare. Të dhënat nga vlerësimi evidentohen në regjistrin e institucioneve të KPSh-së dhe raportohen në baza mujore në Ministrinë e Shëndetësisë. Krahas raportimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe regjistrimit të të dhënave në Sistemin Informativ Shëndetësor, rezultatet e monitorimit të zhvillimit duhet të evidentohen edhe në Fletoren e Fëmijës, përkatësisht në pjesën e zhvillimit të fëmijës.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur tabela monitoruese me indikatorët (treguesit), të cilët duhet të raportohen.

Nr.	Treguesi
1	Numri total i vlerësimeve të monitorimit të zhvillimit të kryera.
2	Numri i fëmijëve të vlerësuar të paktën një herë
3	Numri i vlerësimeve të monitorimit të zhvillimit të kryera (vajza).
4	Numri i vlerësimeve të monitorimit të zhvillimit të kryera me fëmijët nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
5	Numri total i fëmijëve të identifikuar me ngecje në një ose më shumë domene të zhvillimit (gjuha, motorika, raportet, loja dhe vetë kujdesi).
6	Numri i fëmijëve që kërkojnë MBËSHTETJE SHTESË në fushën zhvillimore të gjuhës (shprehëse ose receptive).
7	Numri i fëmijëve që kërkojnë MBËSHTETJE SHTESË në fushën zhvillimore të motorikes (lëvizjeve) së madhe dhe fine.
8	Numri i fëmijëve që kërkojnë MBËSHTETJE SHTESË në fushën zhvillimore të raporteve (lidhjeve).
8	Numri i fëmijëve që kërkojnë MBËSHTETJE SHTESË në fushën zhvillimore të vetë ndihmës.
9	Numri i fëmijëve të identifikuara me një ose më shumë rreziqe zhvillimore shëndetësore.
10	Numri i familjeve të identifikuara me një ose më shumë rreziqe zhvillimore psikosociale.
11	Numri i fëmijëve të referuar tek mjeku familjar për vlerësim të mëtejshëm.

Aneks: Instrumenti GMCD për monitorim të zhvillimit

UDHËZUESI NDËRKOMBËTAR PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT TË FËMIJËS (GMCD)

Emri i institucionit:	
Emri i ofruesit të shërbimit:	
Emri i fëmijës:	
Emri i prindit/kujdestarit:	
Kontakti i familjes:	
Informacione të tjera:	

Vizita 1	Dita	Muaji	Viti
Data e vizitës			
Data e lindjes			
Mosha e kalkuluar			
Nëse MG < 37 (40-MG)			
Mosha e korrigjuar			

Pesha në lindje:	Mosha gestative (MG) javë:
Problemet perinatale nëse janë të pranishme:	
Diagnoza mjekësore nëse është e pranishme:	

PËRKUJTUES

Udhëzuesi GMCD do të përdoret vetëm nga ofruesit që kanë përfunduar Programin e Trajnimit të Ofruesve GMCD, të trajnuar nga trajnerët GMCD të licencuar dhe kanë marrë një certifikatë si ofrues i GMCD. Vetëm hulumtuesit që kanë përfunduar Programin e Trajnimit për Hulumtues GMCD të ofruar nga trajnerë të licencuar të hulumtuesve kanë leje të përdorin GMCD për kërkime.

Udhëzuesi administrohet, kodohet, interpretohet dhe zbatohet sipas Programit të Trajnimit GMCD. GMCD duhet të përdoret për të monitoruar dhe mbështetur zhvillimin individual të çdo fëmije. Nuk duhet të përdoret vetëm për të monitoruar fëmijët për vonesa në zhvillim. Termat si kalimi, dështimi, pikët, përqindjet, ekuivalentët e moshës zhvillimore ose terminologji të tjera potencialisht stigmatizuese nuk duhet të përdoren me GMCD.

Për Udhëzuesin GMCD, mosha e fëmijës tregon muajin e plotë (6 muaj 30 ditë janë 6 muaj, 7 muaj 1 ditë është 7 muaj). Për foshnjat e lindura premature (të lindur më pak se 37 javë të përfunduara MG), deri në moshën 25 muajshe, përdorni moshën e korrigjuar. Shembull: Lindur 30 javë MG, 40 – 30 = 10 javë = 2 muaj + 2 javë; Mosha e korrigjuar = Mosha e llogaritur – (2 muaj 2 javë). Nëse MG nuk dihet, përdorni tabelën për peshën e lindjes në Librin për Mbështetje të Familjes për të përcaktuar MG-në e përafërt.

PËRMBLEDHJE E RREZIQEVE ZHVILLIMORE DHE PLANIT TË NDËRHYRJES TË HERSHME

Rreziqet për shëndetin	Rreziqet psikosociale	Konsultimet/Referimet	Plani i intervenimit të hershëm (IH)
❒ Kequshqyerja/nën ushqyerja	❒ Problemet e shëndetit mendor	❒ Qendra mjekësore	❒ Mbështetje zhvillimore e individualizuar me GMCD
❒ Anemia (Hb<10.5 g/dl)	❒ Vështirësitë financiare	❒ Testimi i dëgjimit	❒ Këshillim ushqimor/këshilla dietike ushqimore
❒ Pesha e ulët në lindje:	❒ Sëmundje në familje	❒ Testimi i shikimit	❒ Referuar në qendrën e kujdesit parësor
❒ Sëmundje kronike:	❒ Dhuna në familje	❒ Specialist i shëndetit mendor të fëmijëve	❒ Referuar në qendrën për ndërhyrje të hershme
❒ Tjetër:	❒ Ndarja e prindërve	❒ Specialist i shëndetit mendor të të rriturve	❒ Shërbime sociale/familjare/OJQ
❒ Tjetër:	❒ Tjetër:	❒ Tjetër:	❒ Tjetër:
❒ Tjetër:	❒ Tjetër:	❒ Tjetër:	❒ Tjetër:

Plani vijues dhe shënimet:

Vizita 2	Dita	Muaji	Viti
Data e vizitës			
Data e lindjes			
Mosha e kalkuluar			
Nëse MG < 37 (40-MG)			
Mosha e korrigjuar			

Vizita 3	Dita	Muaji	Viti
Data e vizitës			
Data e lindjes			
Mosha e kalkuluar			
Nëse MG < 37 (40-MG)			
Mosha e korrigjuar			

Vizita 4	Dita	Muaji	Viti
Data e vizitës			
Data e lindjes			
Mosha e kalkuluar			
Nëse MG < 37 (40-MG)			
Mosha e korrigjuar			

Vizita 5	Dita	Muaji	Viti
Data e vizitës			
Data e lindjes			
Mosha e kalkuluar			
Nëse MG < 37 (40-MG)			
Mosha e korrigjuar			

UDHËZUESI NDËRKOMBËTAR PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT TË FËMIJËS (GMCD)

PYETJET E HAPURA	MOSHA E PLOTË (NË MUAJ) 1-2 MUAJ	3-4 MUAJ	5-6 MUAJ	7-8 MUAJ	9-11 MUAJ	12-14 MUAJ	Mbështetje shtesë
Ashtu siç është e rëndësishme të ndiqni shëndetin dhe rritjen fizike [të fëmijës suaj], është e rëndësishme të ndiqni dhe mbështesni zhvillimin e saj/tij. Truri i fëmijëve zhvillohet më shpejt gjatë viteve të hershme. Është e rëndësishme të monitorohet zhvillimi dhe të shihet nëse ka fusha që kanë nevojë për mbështetje shtesë. Ju e njihni më së miri fëmijën tuaj. Le të flasim 5-10 minuta për zhvillimin e tij/saj. Me zhvillim nënkuptoj të mësuarit, komunikimin, të kuptuarit, lidhjen me njerëzit, lojën, lëvizjen e trupit, përdorimin e duarve dhe gishtërinjve, dëgjimin dhe shikimin". **1. Shqetësimet e prindit. Do të doja t'ju pyesja së pari, a keni ndonjë shqetësim për zhvillimin e fëmijës tuaj në ndonjë nga këto fusha?"** ❒ Jo ❒ Po **Cilat janë shqetësimet e prindit?** *Dëgjoni shqetësimet e prindit dhe tregojini se do t'u kthehemi shqetësimeve kur të keni mësuar për të gjithë procesin e zhvillimit.* **"Tani do t'ju pyes se si po zhvillohet [fëmija juaj] në të gjitha këto fusha. Ju lutem më jepni shembuj të asaj që bën në përditshmëri fëmija juaj".**							
2. Gjuha shprehëse. "Si ju bën të ditur fëmija juaj kur dëshiron diçka? Çfarë lloj tingujsh, gjestesh apo fjalësh përdor fëmija?"	❒ Relaksohet kur mbahet ❒ Bën zëra të ndryshëm kur është i/e gërxuar, irrituar, uritur	❒ Shqipton zanoret ("aa, uu")	❒ Qesh me zë	❒ Bën tinguj zanore-bashkëtingëllore ("ga, da") ❒ Përdor gjeste (tund kokën në shenjë proteste, ngre krahët për ta kapur)	❒ Përsërit rrokjet ("da-da")	❒ Thotë një fjalë kuptimplotë ❒ Përdor krahun ose dorën për të treguar njerëzit ose objektet	
3. Gjuha pranuese. "Si ju tregon fëmija që kupton kur i flisni? Për shembull, çfarë bën ai/ajo kur i thua: Ku është babi? Ku është topi? Eja këtu!"	❒ Reagon kur flet me të, ngadalëson lëvizjet, dëgjon, merr pjesë ❒ Tregon interesimin duke shiquar fytyrën kur flet prindi	❒ Përgjigjet duke lëshuar tinguj kur i flasin prindërit	❒ Fëmija duhet të ketë arritur piketën zhvillimore të shënuar në kolonën e mëparshme		❒ Kupton emrat e njerëzve të njohur (mami, babi, motra)	❒ Kupton foljet/veprimet (eja, merr, ndalo) ❒ Kupton emrat e objekteve (top, lodër)	
4a. Lëvizjet e motorikës së gjerë (muskujt e mëdha). "Më trego për lëvizjen e tij/saj, si mbajtja dhe ngritja e kokës, pozita ulur, duke ecur."	❒ Ngre fytyrën kur shtrihet në bark ❒ Kthen kokën ❒ Lëviz krahët dhe këmbët në mënyrë të barabartë nga të dyja anët	❒ Ngrit dhe mban kokën në mënyrë të qëndrushme	❒ Ngre kokën 90° ❒ Ulet me ndihmë ❒ Kur mbahet në këmbë, drejton këmbët, shtyn kundër diçkaje në vend që të përkulë këmbët	❒ Rrotullohet para prapa në shpinë, dhe anasjelltas	❒ Ulet pa ndihmë	❒ Mundohet të qëndrojë duke u mbajtur në objekte ❒ Arrin të qëndrojë në këmbë për një çast pa u mbajtur ❒ Ecën duke u mbajtur pas objekteve	
4b. Lëvizjet e motorikës fine (muskujt e vegjël). "Si i përdor duart dhe gishtat e tij/saj, si për shembull mbajtja e gjësendeve?"	❒ Mban duart hapur (jo grushtuar) disa herë	❒ Bashkon duart në mes	❒ Mban duart hapur (jo grushtuar) shumicën e kohës ❒ Zgjatet drejt objekteve me duar ❒ Kap, mban lodrat/ gjësendet (jo refleks i mbajtjes)	❒ Bart objektet nga një dorë në dorën tjetër duke përdorur gishtat dhe pëllëmbën	❒ Kap objekte të vogla (si copa ushqimi) duke përdorur gishtat (gishtin e madh dhe gishtin tregues) të ndihmuar nga gishtërinjtë e tjerë	❒ Kap objekte të vogla duke përdorur vetëm gishtat (gishti i madh dhe gishti tregues)	
5. Raportet "Si lidhet fëmija juaj me njerëzit që njeh? Si tregon interes për ta?" Çfarë bën për t'i mbajtur aktiv ata? Si është kontakti me sy? *Prisni që prindi/kujdestari të përgjigjet, më pas pyesni:* **"Si reagon fëmija me të huajt?" "Si reagon fëmija që e di se ata janë të huaj?"**	❒ Shikon, përcjellë fytyrat ❒ Buzëqesh kur i flet këndshëm prindi	❒ Mban kontakt të zgjatur dhe kuptimplotë me sy	❒Tregon dëshirën për t'u angazhuar me njerëzit duke parë, buzëqeshur, duke arritur, duke lëshuar tinguj ❒ Tregon preferencën dhe njohjen e prindërve duke prekur, buzëqeshur, apo inspektuar fytyrat e tyre	❒ Reagon kur prindi largohet, qetësohet kur bashkohet	❒ Tregon njohjen e të huajit në një farë mënyre (mund të largohet nga të huajt në ankth, kujdes, ndrojë, frikë ose mund të vështrojë për një kohë të gjatë)	❒ Në mënyrë spontane kërkon të ndajë kënaqësinë dhe interesin me të tjerët (përqafon prindin, puth, inspekton lodrën së bashku)	
6. Përfshirja në aktivitete. "Më tregoni për lojën e fëmijës suaj. Si luan fëmija me njerëzit, me gjëra apo lodra?" *Pyetni nëse është e nevojshme* **" Çfarë lodrash ka fëmija, si luan me to?"**	❒ Bashkëpunon kur luan me prindërit (lëviz gjymtyrët)	❒ Bën tinguj në përgjigje të luajtjes	❒ Kap lodrat/gjësendet me interes (jo refleks) ❒ I sjell lodrat/ gjësendet në gojë ❒ Shikon duart e veta	❒ I përgjigjet lojës interaktive si "peek-a-boo" ❒ Gjuan, përplas lodra/ gjësende ❒ Shikund lodrat/gjësendet gjatë lojës	❒ Kërkon lodra/objekte që zhduken ❒ Inspekton me kureshtje lodrat/ objektet, shikon detajet ❒ Imiton gjestet gjatë lojës (përplasja e duarve, fytyra)	❒ Fillon lojën "peek-a-boo" ❒ Inspekton se si funksionojnë lodrat/objektet (si motullohen rrotat, lëviz kukulla, ndizen dritat)	
7. Aktivitetet e vetëkujdesit. "Çfarë lloj gjërash bën fëmija për vetëkujdesin, si qëndron në ushqyerjen e pavarur?	❒ Fëmijët në këtë moshë nuk pritet të arrijnë piketat zhvillimore të vetëkujdesit					❒ Përdor gishtat për të ushqyer veten (e di se është ushqim dhe hal	
8. Ambienti I kujdesit gjithëpërfshirës. "Faleminderit që më tregove për zhvillimin e fëmijës tuaj, ju e njihni atë shumë mirë. Tani të lutem më trego për përditshmërinë e tij/saj. Çfarë bëni ju dhe familja për ta mbështetur atë të zhvillohet, të mësojë, të komunikojë?" *Dëgjoni atë që po ju thotë prindi. Nxitoni duke pyetur: "Çfarë bëjnë anëtarët e tjerë të familjes dhe miqtë me të?" Mbështetni prindërit duke lavdëruar përpjekjet e tyre. Jepni ide nga Libri për Mbështetje të Familjes, ose "Unë Zhvillohem me Ty" kur është e përshtatshme.* **9. Rreziqet e zhvillimit. "Ndonjëherë prindërit mund të kenë shumë gjëra që po ndodhin. Për shembull, ata mund të ndihen të mbingarkuar, të stresuar ose të dëshpëruar, mund të ketë probleme financiare ose sëmundje në familje dhe mund ta kenë të vështirë të mbështesin zhvillimin e fëmijës së tyre. A ka vështirësi të tilla apo të tjera në situatën tuaj familjare?"** *Dëgjoni me ndjeshmëri dhe identifikoni faktorët e rrezikut psikosocial. Nëse është e përshtatshme, pyesni edhe për abuzimin me substancat apo dhunën.* **10. Planifikimi për ndërhyrje dhe përcjellje. "Cilat janë disa ide apo plane që keni për të mbështetur zhvillimin [e fëmijës suaj] pavarësisht këtyre vështirësive? Në këtë moshë të hershme kur zhvillimi është kaq i rëndësishëm, çfarë mund të bëni ju, familja juaj, miqtë dhe komuniteti për ta ndihmuar atë të zhvillohet?"** *Mbështetni përpjekjet e prindërve. Nëse prindërit nuk kanë ide apo plane, thuani se do të dëshironit të flisni më tej me ta për këto. Jepni komentet tuaja për GMCD dhe planifikoni vizitën e radhës.*							

© Prof. Dr. Ilgi Ertem, Universiteti i Ankarasë. GMCD duhet të përdoret vetëm nga ofruesit që kanë përfunduar Programin e Trajnimit GMCD të ofruar nga trajnerë të licencuar të GMCD dhe kanë marrë një Certifikatë Ofruesi GMCD. GMCD nuk mund të përdoret për klinikime pa plotësuar Programin e Trajnimit të Klinikuesve GMCD dhe pa marrë një Certifikatë Klinikuesi GMCD.

UDHËZUESI NDËRKOMBËTAR PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT TË FËMIJËS (GMCD)

PYETJET E HAPURA	MOSHA E PLOTË (NË MUAJ) 15-17 MUAJ	18-21 MUAJ	22-25 MUAJ	26-29 MUAJ	30-35 MUAJ	36-42 MUAJ	Mbështetje shtesë
Ashtu siç është e rëndësishme të ndiqni shëndetin dhe rritjen fizike [të fëmijës suaj], është e rëndësishme të ndiqni dhe mbështesni zhvillimin e saj/tij. Truri i fëmijëve zhvillohet më shpejt gjatë viteve të hershme. Është e rëndësishme të monitorohet zhvillimi dhe të shihet nëse ka fusha që kanë nevojë për mbështetje shtesë. Ju e njihni më së miri fëmijën tuaj. Le të flasim 5-10 minuta për zhvillimin e tij/saj. Me zhvillim nënkuptoj të mësuarit, komunikimin, të kuptuarit, lidhjen me njerëzit, lojën, lëvizjen e trupit, përdorimin e duarve dhe gishtërinjve, dëgjimin dhe shikimin". **1. Shqetësimet e prindit. Do të doja t'ju pyesja së pari, a keni ndonjë shqetësim për zhvillimin e fëmijës tuaj në ndonjë nga këto fusha?"** ❒ Jo ❒ Po **Cilat janë shqetësimet e prindit?** *Dëgjoni shqetësimet e prindit dhe tregojini se do t'u ktheheni shqetësimeve kur të keni mësuar për të gjithë procesin e zhvillimit.* **"Tani do t'ju pyes se si po zhvillohet [fëmija juaj] në të gjitha këto fusha. Ju lutem më jepni shembuj të asaj që bën në përditshmëri fëmija juaj".**							
2. Gjuha shprehëse. "Si ju bën të ditur fëmija juaj kur dëshiron diçka? Çfarë lloj tingujsh, gjestesh apo fjalësh përdor fëmija?"	❒ Relaksohet kur mbahet ❒ Bën zëra të ndryshëm kur është i/e gëzuar, irrituar, uritur	❒ Shqipton zanoret ("aa, uu")	❒ Qesh me zë	❒ Bën tinguj zanore-bashkëtingëllore ("ga, de") ❒ Përdor gjeste (tund kokën në shenjë proteste, ngre krahët për ta kapur)	❒ Përsërit rrokjet ("da-da")	❒ Thotë një fjalë kuptimplotë ❒ Përdor krahun ose dorën për të treguar njerëzit ose objektet	
3. Gjuha pranuese. "Si ju tregon fëmija që kupton kur i flisni? Për shembull, çfarë bën ai/ajo kur i thua: Ku është babi? Ku është topi? Eja këtu!"	❒ Reagon kur flet me të, ngadalëson lëvizjet, dëgjon, merr pjesë ❒ Tregon interesimin duke shiquar fytyrën kur flet prindi	❒ Kupton një urdhër të thjeshtë (sjelli këpucët)	❒ Kupton më shumë se një urdhër të thjeshtë	❒ Përgjigjet pyetjeve të thjeshta si "A është mami në shtëpi?" -> "po" ose "jo" ❒ Kupton emrat e më shumë se tre objekteve ❒ Dëgjon histori të shkurtra or kur prindërit tregojnë një ngjarje	❒ Kupton një parafjalë (përveç "në") si "nën" ose "përmbi"	❒ Kupton udhëzimet dypalëshe ("shko në kuzhinë dhe më sill pjatën tënde", "shko në dhomën tënde dhe sill topin")	
4a. Lëvizjet e motorikës së gjerë (muskujt e mëdha). "Më trego për lëvizjen e tij/saj, si mbajtja dhe ngritja e kokës, pozita ulur, duke ecur."	❒ Ec i pavarur	❒ Godit topin me këmbë ose ndonjë objekt tjetër	❒ Fëmija duhet të ketë arritur piketën zhvillimore të shënuar në kolonën e mëparshme				
4b. Lëvizjet e motorikës fine (muskujt e vegjël). "Si i përdor duart dhe gishtat e tij/saj, si për shembull mbajtja e gjësendeve?"	❒ Mban laps ose shkop (në çfarëdo mënyre) dhe shkarravit në letër ose në tokë/dysheme	❒ Fëmija duhet të ketë arritur piketën zhvillimore të shënuar në kolonën e mëparshme				❒ Mban me gishta lapsin ose shkopin dhe vizaton	
5. Raportet "Si lidhet fëmija juaj me njerëzit që njeh? Si tregon interes për ta?" Çfarë bën për t'i mbajtur aktiv ata? Si është kontakti me sy? *Prisni që prindi/kujdestari të përgjigjet, më pas pyesni.* **"Si reagon fëmija me të huajt?" "Si reagon fëmija që e di se ata janë të huaj?"**	❒ Imiton sjelljet e të tjerëve (bën me dorë, shkarravitë, pastron duart, palon teshat)	❒ Inicon ndërveprime me njerëzit		❒ Fëmija duhet të ketë arritur piketën zhvillimore të shënuar në kolonën e mëparshme		❒ Flet për njerëzit/miqtë e preferuar kur nuk janë me të ("ku është gjyshi?")	
6. Përfshirja në aktivitete. "Më tregoni për lojën e fëmijës suaj. Si luan fëmija me njerëzit, me gjëra apo lodra?" *Pyetni nëse është e nevojshme.* **" Çfarë lodrash ka fëmija, si luan me to?"**	❒ Hulumton se si funksionojnë lodrat (si rrotullohen rrotat,si lëviz kukulla, shtyp zilet, ndez dritat)	❒ Realizon lojë të thjeshtë imagjinare si: të ushqyerit e dikujt apo kukullës, ngasjen e makinave, kalërimin e kafshëve	❒ Përfshin të tjerët në lojë	❒ Fëmija duhet të ketë arritur piketën zhvillimore të shënuar në kolonën e mëparshme		❒ Krijon lojëra më komplekse që përfshin dy ose më shumë ide të tilla si gatimi dhe ushqyerja e një kukulle; drejtimi dhe mbushja e makinës, vetëm ose me të tjerët	
7. Aktivitetet e vetëkujdesit. "Çfarë lloj gjërash bën fëmija për vetëkujdesin, si qëndron në ushqyerjen e pavarur?	❒ Fëmija duhet të ketë arritur piketën në kolonën e mëparshme me 14 muaj		❒ Përdor njërin nga mjetet ushqyese ❒ Pi nga gota		❒ Zhvesh ndonjërën nga veshmbathjet ❒ Pastron duart me ndihmë	❒ Përdor tualetin gjatë ditës ❒ Pastron dhëmbët me ndihmë	
8. Mjedisi i kujdesit gjithëpërfshirës. "Faleminderit që më tregove për zhvillimin [e fëmijës suaj], ju e njihni atë shumë mirë. Tani ju lutem më tregoni për jetën e përditshme të fëmijës suaj. "Çfarë bëni ju dhe familja juaj për ta mbështetur atë të zhvillohet, të mësojë, të komunikojë?" Dëgjoni atë që prindi/kujdestari po ju thotë. Nxiteni duke e pyetur. "Çfarë bëjnë anëtarët e tjerë të familjes dhe miqtë me të?" Mbështetni prindërit/kujdestarët duke pranuar dhe lavdëruar të gjitha përpjekjet e tyre. Jepni ide nga Libri për Mbështetje të Familjes, ose "Unë Zhvillohem me ty" kur është e nevojshme.							
9. Rreziqet e zhvillimit. "Ndonjëherë tek prindërit mund të ndodhin shumë gjëra. Për shembull, ata mund të ndihen të mbingarkuar, të stresuar ose të dëshpëruar, mund të ketë probleme financiare ose sëmundje në familje dhe kujdestarët mund ta kenë të vështirë të mbështesin zhvillimin e fëmijës së tyre. A ka vështirësi të tilla apo të tjera në situatën tuaj familjare?" Dëgjoni me ndjeshmëri dhe identifikoni faktorët e rrezikut psikosocial. Nëse është e përshtatshme, pyesni edhe për abuzimin me substancat, dhunën.							
10. Planifikimi për ndërhyrje dhe ndjekje. "Cilat janë disa ide apo plane që keni për të mbështetur zhvillimin [e fëmijës suaj] pavarësisht këtyre vështirësive? Në këtë moshë të hershme kur zhvillimi është kaq i rëndësishëm, çfarë mund të bëni ju, familja juaj, miqtë dhe komuniteti për ta ndihmuar atë të zhvillohet?" Dëgjoni me ndjeshmëri dhe identifikoni faktorët e rrezikut psikosocial. Nëse është e përshtatshme, pyesni edhe për abuzimin me substancat apo dhunën. **10. Planifikimi për ndërhyrje dhe përcjellje. "Cilat janë disa ide apo plane që keni për të mbështetur zhvillimin [e fëmijës suaj] pavarësisht këtyre vështirësive? Në këtë moshë të hershme kur zhvillimi është kaq i rëndësishëm, çfarë mund të bëni ju, familja juaj, miqtë dhe komuniteti për ta ndihmuar atë të zhvillohet?"** Mbështetni përpjekjet e prindërve. Nëse prindërit nuk kanë ide apo plane, thuajuni se do të dëshironit të flisni më tej me ta për këto. Jepni komentet tuaja për GMCD dhe planifikoni vizitën e radhës.							

© Prof. Dr. Ilgi Ertem, Universiteti i Ankarasë. GMCD duhet të përdoret vetëm nga ofruesit që kanë përfunduar Programin e Trajnimit GMCD të ofruar nga trajnerë të licencuar të GMCD dhe kanë marrë një Certifikatë Ofruesi GMCD. GMCD nuk mund të përdoret për kërkime pa plotësuar Programin e Trajnimit të Kërkuesve GMCD dhe pa marrë një Certifikatë Hulumtuesi GMCD.